

# STATUTI

## I

### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

### “GOGO’S RESIDENCE 2022” SH.P.K

#### Kapitulli I

#### EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

#### Neni 1 – Forma

- 1) Shoqëria “GOGO’S RESIDENCE 2022” SH.P.K është krijuar me mjetet monetare në pronësi të themeluesve të saj:
- Z. Gjergj Ruci, atësia Llambro, lindur në Tiranë në datë 02.06.1978 dhe banues në Tiranë, me Adresën " Rr. Reshit Çollaku, Pallatet Lani" me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H80602062J lëshuar në datën 01.12.2020;*
  - Z. Julian Ruci, atësia Jerasimo, lindur në Lushnje në datë 25.04.1977 dhe banues në Tiranë, me Adresën "Rr. Frosina Plaku ,Kompleksi Kontakt", me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H70425244Q lëshuar në datën 21.10.2019;*
  - Z. Blendi Tufa, atësia Abdurahman, lindur në Tiranë në datë 29.05.1978 dhe banues në Tiranë, me Adresën " Rr. Siri Kodra 42/1," me shtetësi shqiptare, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i ID Nr H80529064T lëshuar në datën 05.07.2012.*
- d) Shoqëria vepron sipas ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.
- e) Shoqëria ka vulën e saj zyrtare.

#### Neni 2 – Emri

- a) Emri i Shoqërisë është: “GOGO’S RESIDENCE 2022” SH.P.K

#### Neni 3 – Objekti

- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si vijon:
- Aktivitet në fushën e shërbimeve të Turizmit.
- Hoteleri
- Kafe – Bar,
- Restorant. etj.



1

- Shoqëria mund të bashkëpunojë dhe/ose të marrë direkt ose indirekt interesa, në shoqëri, firma, agjensi dhe ndërmarrje të tjera, të cilat mund të kenë edhe qëllime të tjera aktiviteti.
- Gjithashtu, për të realizuar objektin dhe qëllimet e saj, Shoqëria mund të ndërmarrë dhe zhvillojë çdo lloj aktiviteti lidhur me shitblerjen e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, si edhe çdo aktivitet tregtar, financiar, qiradhënës apo dorëzënës, që i vlerëson të dobishme apo të nevojshme për arritjen e qëllimeve të saj.

#### **Neni 4 – Selia**

- a) Selia zyrtare e shoqërisë është në adresën: Lagjia Drimadhes, Rruga Perivolo Objekt Privat Nr. 68, Dhermi, Himare, Vlore.

#### **Neni 5 – Kohëzgjatja**

- a) Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pa kufizuar.
- b) Shoqëria mund të përfundojë apo vihet në likuidim përpara këtij afati me vendim të asamblesë së ortakëve.

#### **Neni 6 – Përgjegjësitë**

- a) Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti.
- b) Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emrat e tyre personalë ndaj personave të tretë.

### **Kapitulli II**

#### **KAPITALI I SHOQËRISË**

##### **Neni 7 – Kapitali**

Kapitali i nënshkruar i shoqërisë "GOGO'S RESIDENCE 2022" SHPK është 100.000 (njëqindmijë) lekë

##### **Neni 8 – Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre**



1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100,000 Lekë (njëqind mijë) i ndarë me 3 kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku Z. Gjergj Ruci Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 34,000 (tridhjetë e katër mijë) Lekë që përbën 34% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
2. Ortaku Z. Julian Ruci Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 33,000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.
3. Ortaku Z. Blendi Tufa Zotërues i 1 kuote me vlerë të përgjithshme 33,000 (tridhjetë e tre mijë) Lekë që përbën 33% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

#### **Neni 9 – Zmadhimi i kapitalit**

- a) Ortakët mund të rrisin pa kufi kapitalin e shoqërisë.
- b) Ortakët njoftojnë për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.
- c) Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- d) Pas miratimit të pasqyrave financiare të vitit paraardhës, asambleja e përgjithshme vendos edhe për fitimet e realizuara. Asambleja mund të vendosë që me këto fitime të zmadhojë kapitalin e regjistruar, të rrisi rezervat statutorë ose të shpërndajë dividend.
- e) Në asnjë rast nuk mund të rritet kapitali i shoqërisë pa mbuluar më parë humbjet e rezultuara në pasqyrat financiare.

#### **Neni 10 – Krijimi i rezervave**

- a) Mbas miratimit të pasqyrave financiare, asambleja krijon rezerva statutorë sipas ligjit. Kur këto rezerva të kapin shumën sa 10% të kapitalit themeltar, asambleja e ortakëve mund të mos krijojë më rezerva.

#### **Neni 11 – Zvogëlimi i kapitalit themeltar**



- a) Ortaku mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
- b) Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Biznesit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

#### **Neni 12 – Transferimi i kuotave të kapitalit**

- a) Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen lirisht të tretëve, tërësisht ose pjesërisht, me të drejtë parablerje nga ortakët.

#### **Neni 13 - Pasojat e kalimit të kuotave**

- a) Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë, për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

### **Kapitulli III**

## **ORTAKËT, ADMINISTRIMI, KONTROLLI**

#### **Neni 14 – Të drejtat dhe detyrimet**

- 1. Ortakët janë përgjegjës për marrjen e vendimeve për Shoqërinë lidhur me çështjet e mëposhtme:
  - a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
  - b) Ndryshimet e statutit;
  - c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
  - d) Emërimin, shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike
  - f) Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - g) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
  - h) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
  - i) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
  - j) Përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
  - k) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë
  - l) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji.



### **Neni 15 - Procesverbalet**

- a) Të gjitha vendimet e ortakeve regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të shoqërisë.

### **Neni 16 - Hetimet e posaçme**

- a) Ortakët mund të vendosin nisjen e një hetimi të posaçëm, për parregullsitë përgjatë ushtrimit të veprimtarisë tregtare, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 91 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### **Neni 17 -Shfuqizimi i vendimeve të parregullta dhe dëmshpërblimi**

- a) Ortakët kanë të drejtë t'i kërkojnë gjykatës përkatëse shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, kur këto përbëjnë shkelje të rëndë të ligjit ose të statutit, në përputhje me rregullat e përcaktuara në nenin 92 të Ligjit Nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### **Neni 18 – Administrimi**

- A. Shoqëria administrohet nga administratorët. Ortakët emërojnë një ose më shumë persona fizikë si administratorë. Duke filluar nga data e miratimit të këtij statuti, administrator i vetëm i shoqërisë "GOGO'S RESIDENCE 2022" SHPK do të jetë z. Gjergj Ruci me afat 5 vjeçar;
- B. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortakët;
  - b) Përfaqësojë Shoqërinë;
  - c) Kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
  - d) Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpara ortakëve për miratim;
  - e) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
  - f) Kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;



- g) Raportojnë përpara ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- C. Ortakët mund të zëvendësojnë administratorin në çdo kohë.

#### **Neni 19 - Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

- a) Administratorët detyrohen të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim që vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale.

#### **Kapitulli IV**

#### **SHPËRNDARJA E FITIMIT**

#### **Neni 20 - Shpërndarja e fitimeve**

- a) Ortaket kanë të drejtë të marrin pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

#### **Kapitulli V**

#### **SHPËRBËRJE E SHOQËRISË**

#### **Neni 21 - Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

#### **A. Shoqëria prishet:**

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakëve
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk kryen veprimtari tregtare për tre vjet
- d) me vendim të gjykatës;

Ky statut hartohet në 3 kopje në gjuhën shqipe.

Vlore me 18.05.2022

Lexuar, nënshkruar

#### **ORTAKET E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "GOGO'S RESIDENCE 2022" SH.P.K**

Z. Gjergj Ruci



Z. Julian Ruci



Z. Blendi Tufa

